



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 29.7.2024, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR “KLUBIN E BASKETBOLLIT
TË FEMRAVE PRISHTINA”

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për “KBF PRISHTINA”

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 20,000.00 € (njëzetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, Kupa e Kosovës për tri gjenerata, Seniore, U18, U16, Liga unike dhe pjesëmarrja ne European Women’s Basketball League.

IV.

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e “KBF PRISHTINA”

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-022/01-99485/24, më 31.7.2024

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina

